3	Diphenoxylate	A07DA01	1-(3-cyano-3,3-diphenylpropyl)-4-phenylpiperidine-4-carboxylic acid ethyl ester
4	Fentanyl	N01AH01	<i>l</i> -phenethyl-4- <i>N</i> -propionylanilinopiperidine
5	Hydrocodone	R05DA03	4,5 α -epoxy-3-methoxy-17-methylmorphinan-6-one
6	Methadone	N07BC02	6-dimethylamino-4,4-diphenyl-3-heptanone
7	Levomethadone*	N07BC05	(<i>R</i>)-6-Dimethylamino-4,4-diphenylheptan-3-on
8	Morphine	N02AA01	(5 <i>R</i> ,6 <i>S</i>)-4,5-Epoxy-17-methyl morphin-7-en-3,6-diol
9	Oxycodone	N02AA05	14-hydroxydihydrocodeinone
10	Oxymorphone	N02AA11	14-hydroxydihydromorphinone
11	Pethidine	N02AB02	<i>l</i> -methyl-4-phenylpiperidine-4-carboxylic acid ethyl ester
12	Piritramide	N02AC03	<i>l</i> -(3-cyano-3,3-diphenylpropyl)-4-(1-piperidino)-piperidine-4-carboxylic acid amide
13	Sufentanil	N01AH03	<i>N</i> -[4-(methoxymethyl)-1-[2-(2-thienyl)-ethyl]-4-piperidyl]propionanilide
14	Remifentanil	N01AH06	<i>l</i> -(2-methoxy carbonyl ethyl)-4-(phenylpropionylamino)piperidine-4-carboxylic acid methyl ester
15	Tilidine	N02AX01	(\pm)-ethyl-trans-2-(dimethylamino)-1-phenyl-3-cyclohexene-1-carboxylate
16	Acetyldihydrocodeine**	R05DA12	3-methoxy-6-acetoxy-(5 α ,6 α)-4,5-epoxy-17-methylmorphinan
17	Codeine**	R05DA04	3- <i>O</i> -methylmorphine
18	Dextropropoxyphene**	N02AC04	α -(+)-4-dimethylamino-1,2-diphenyl-3-methyl-2-butanol propionate
19	Dihydrocodeine**	R05DA03	4,5 α -Epoxy-3-methoxy-17-methylmorphinan-6 α -ol

Tabela II - Barnat narkotike dhe substancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë

20	Ethylmorphine**	R05DA01	3-O-ethylmorphine
21	Pholcodine**	R05DA08	morpholinylethylmorphine

Izomerët, përveç rasteve kur përjashtohen në mënyrë specifike, të barnave në këtë Tabelë sa herë që ekzistenca e izomereve të tillë është e mundur brenda emërimit kimik specifik (vetëm për substancat nga numri rendor 1 deri 20);

Esteret dhe eteret, me përjashtim të rasteve kur shfaqen në një listë tjetër, të barnave në këtë listë sa herë që është e mundur ekzistenca e këtyre estereve ose etereve;

Kripërat e barnave të listuara në këtë tabelë, duke përfshirë kripërat e estereve, etereve dhe izomereve siç janë dhënë më sipër sa herë që është e mundur ekzistenca e këtyre kripërave.

** Levomethadone nuk është i përfshirë shprehimisht në Konventën e Vetme të Kombeve të Bashkuara për Lëndët Narkotike të vitit 1961, por në praktikë konsiderohet si i mbuluar nga dispozitat për methadone-in, duke qenë se përfaqëson enantiomerin e tij farmakologjikisht aktiv.*

*** Përgatesat dhe statusi i këtyre përgatesave me përmbajtje të substancave narkotike të shenjuara, janë të prezentuar në Tabelën III.*

Substancat shtesë të përfshira në vitin 2025 në Tabelën II*:**

22	Ketamine	N01AX03	(RS)-2-(2-Chlorophenyl)-2-(methylamino)cyclohexanone
23	Tramadol	N02AX02	2-[(dimethylamino)methyl]-1-(3-methoxyphenyl)cyclohexan-1-ol

****Në rekomandim të nismës 'Koalicioni Global për Adresimin e Kërcënimit nga Substancat Narkotike Sintetike', që numëron bashkëpunimin e mbi 140 shteteve me SHBA-në për ngritjen e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit publik prej kërcënimit nga narkotikët sintetik sikurse që është fentani, tramadoli, katinonet, kanabinoidi sintetik, metamfetamina, kaptagoni, MDMA dhe ketamina.*

Tabela III - Barnat narkotike dhe substancat psikotrope të rrezikshme dhe përgatesat e tyre, që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë

TABELA III - Substancat psikotrope			
Nr	Substancat psikotrope	ATC - kodi	Emri Kimik
1	Alprazolam	N05BA12	<i>8-chloro-1-methyl-6-phenyl-4H-s-triazolo[4,3-a][1,4]benzodiazepine</i>
2	Bromazepam	N05BA08	<i>7-bromo-1,3-dihydro-5-(2-pyridyl)-2H-1,4- benzodiazepin-2-one</i>
3	Buprenorphine	N07BC01	<i>21-cyclopropyl-7-α-[(S)-1-hydroxy-1,2,2-trimethylpropyl]-6,14-endo-ethano-6,7,8,14-tetrahydrooripavine</i>
4	Clonazepam	N03AE01	<i>5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-7-nitro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
5	Clobazam	N05BA09	<i>7-chloro-2-(methylamino)-5-phenyl-3H-1,4-benzodiazepine-4-oxide</i>
6	Diazepam	N05BA01	<i>7-chloro-1,3-dihydro-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
7	Lorazepam	N05BA06	<i>7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-3-hydroxy-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
8	Midazolam	N05CD08	<i>8-chloro-6-(o-fluorophenyl)-1-methyl-4H-imidazo[1,5-a][1,4]benzodiazepine</i>
9	Nitrazepam	N05CD02	<i>1,3-dihydro-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
10	Phenobarbital	N03AA02	<i>5-ethyl-5-phenylbarbituric acid</i>
11	Prazepam	N05BA11	<i>7-chloro-1-(cyclopropylmethyl)-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
12	Allobarbital	N05CA21	<i>5,5-diallylbarbituric acid</i>
13	Amobarbital	N05CA02	<i>5-ethyl-5-isopentylbarbituric acid</i>
14	Barbital	N05CA04	<i>5,5-diethylbarbituric acid</i>
15	Brotizolam	N05CD09	<i>2-bromo-4-(o-chlorophenyl)-9-methyl-6H-thieno[3,2-f]-s-triazolo[4,3-a][1,4]diazepine</i>
16	Camazepam	N05BA15	<i>7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one dimethylcarbamate (ester)</i>

Tabela III - Barnat narkotike dhe substancat psikotrope të rrezikshme dhe përgatesat e tyre, që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë

17	Chlordiazepoxide	N05BA02	<i>7-chloro-2-(methylamino)-5-phenyl-3H-1,4-benzodiazepine-4-oxide</i>
18	Clorazepate	N05BA05	<i>7-chloro-2,3-dihydro-2-oxo-5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine-3-carboxylic acid</i>
19	Clotiazepam	N05BA21	<i>5-(o-chlorophenyl)-7-ethyl-1,3-dihydro-1-methyl-2H-thieno[2,3-e]-1,4-diazepin-2-one</i>
20	Cloxazolam	N05BA22	<i>10-chloro-11b-(o-chlorophenyl)-2,3,7,11b-tetrahydro-oxazolo-[3,2-d][1,4]benzodiazepin-6(5H)-one</i>
21	Estazolam	N05CD04	<i>8-chloro-6-phenyl-4H-s-triazolo[4,3-a][1,4]benzodiazepine</i>
22	Ethyl loflazepate	N05BA18	<i>ethyl 7-chloro-5-(o-fluorophenyl)-2,3-dihydro-2-oxo- 1H-1,4-benzodiazepine-3-carboxylate</i>
23	Fencamfamin tab 2 de	N06BA06	<i>N-ethyl-3-phenyl-2-norbornanamine</i>
24	Fludiazepam	N05BA17	<i>7-chloro-5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-2H- 1,4-benzodiazepin-2-one</i>
25	Flunitrazepam	N05CD03	<i>5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-2H- 1,4-benzodiazepin-2-one</i>
26	Flurazepam	N05CD01	<i>7-chloro-1-[2-(diethylamino)ethyl]-5-(o-fluorophenyl)- 1,3-dihydro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
27	Halazepam	N05BA13	<i>7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-1-(2,2,2-trifluoroethyl)- 2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
28	Ketazolam	N05BA10	<i>11-chloro-8,12b-dihydro-2,8-dimethyl-12b-phenyl-4H-[1,3]oxazino[3,2-d][1,4]benzodiazepin-4,7(6H)- dione</i>
29	Loprazolam	N05CD11	<i>6-(o-chlorophenyl)-2,4-dihydro-2-[(4-methyl-1-piperazinyl)methylene]-8-nitro-1H-imidazo[1,2-a][1,4]benzodiazepin-1-one</i>
30	Lormetazepam	N05CD06	<i>7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
31	Medazepam	N05BA03	<i>7-chloro-2,3-dihydro-1-methyl-5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine</i>
32	Methylphenidate	N05BA03	<i>methyl α-phenyl-2-piperidine acetate</i>
33	Methylphenobarbital	N03AA01	<i>5-ethyl-1-methyl-5-phenylbarbituric acid</i>
34	Nimetazepam	N05CD15	<i>1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>

Tabela III - Barnat narkotike dhe substancat psikotrope të rrezikshme dhe përgatesat e tyre, që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë

35	Nordazepam	N05BA16	<i>7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
36	Oxazepam	N05BA04	<i>7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
37	Pinazepam	N05BA14	<i>7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-1-(2-propynyl)-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
38	Pipradrol	N06BX15	<i>1,1-diphenyl-1-(2-piperidyl)methanol</i>
39	Temazepam	N05CD07	<i>7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one</i>
40	Triazolam	N05CD05	<i>8-chloro-6-(o-chlorophenyl)-1-methyl-4H-s-triazolo[4,3-a][1,4] benzodiazepine</i>
41	Zolpidem	N05CF02	<i>N,N,6-trimethyl-2-p-tolylimidazo[1,2-a]pyridine-3-acetamide</i>

Kripërat e substancave të listuara në këtë listë kundohet që ekzistenca e kripërave të tilla është e mundur.

TABELA III - Përgatesat

1. Përgatesat e: Acetyldihydrocodeine, Codeine, Dihydrocodeine, Ethylmorphine, Nicococodine, Nicodicodine, Norcodeine dhe Pholcodine të cilat përmbajnë barë narkotikë jo më tepër se 100 miligram për dozë dhe me koncentrim jo më të madh se 2.5% në kuadër të përgatesës dhe që përmbajnë një ose më tepër përbërës të tjerë.

2. Përgatesa e substancës dextropropoxyphene për aplikim oral, që përmban jo më tepër se 135 miligram dextropropoxyphene për dozë ose me koncentrim jo më tepër se 2.5% në kuadër të përgatesës, e cila nuk përmban ndonjë substancë psikotrope të kontrolluar nën Konventën për Sustanca Psikotrope të vitit 1971.

3. Përgatesa e morfinës e cila përmban jo më tepër se 0.2% morfinë të kalkuluar si morfin anhidrik bazë dhe e përzier me një ose më tepër përbërës të tjerë dhe të cilat nuk mund të përfitohen me metoda të aplikueshme për të rrezikuar shëndetin publik.

4. Përgatesa e substancës difenoxin që përmban jo më tepër se 0.5 miligram difenoksin dhe atropin sulfat ekuivalent me së paku 5% të dozës së difenoksinës.

5. Përgatesa e substancës diphenoxylate që përmban jo më tepër se 2.5 miligram difenoksilat të kalkuluar si bazë dhe atropin sulfat ekuivalent me 1% të dozës së difenoksilatit.

6. Përgatesa të tjera që përmbajnë substanca të tjera nga Tabela II, III dhe IV.

Tabela IV - Prekursorët

Kategoria I				
Nr.	Prekursorët	Dizajnimë CN (nëse është ndryshe)	CN Kodi (¹)	CAS Nr. (²)
1	1-Phenyl-2-propanone	<i>Phenylacetone</i>	2914 31 00	103-79-7
2	Diethyl (phenylacetyl) propane-dioate (DEPAD)		2918 30 00	20320-59-6
3	Methyl <i>alpha</i> -phenylacetoacetate (MAPA)		2918 30 00	16648-44-5
4	Ethyl <i>alpha</i> -phenylacetoacetate (EAPA) (4)		Ex 2918 30 00	5413-05-8
5	2-methyl-3-phenyloxirane-2-carboxylic acid (BMK glycidic acid) (6)		2918 99 90	25547-51-7
6	N-acetylanthranilic acid	<i>2-Acetamidobenzoic acid</i>	2924 23 00	89-52-1
7	<i>Alpha</i> -phenylacetoacetamide (APAA)		2924 29 70	4433-77-6
8	<i>Alpha</i> -phenylacetoacetonitrile (APAAN)		2926 40 00	4468-48-8
9	Isosafrol (cis + trans)		2932 91 00	120-58-1
10	3,4-Methylenedioxyphenylpropan-2-one	<i>1-(1,3-Benzodioxol-5-yl)propan-2-one</i>	2932 92 00	4676-39-5
11	Piperonal		2932 93 00	120-57-0
12	Safrole		2932 94 00	94-59-7
13	Methyl 3-oxo-2-(3,4-methylenedioxyphenyl)butanoate (MAMDDPA) (5)	<i>methyl 3-oxo-2-(3,4-methylenedioxyphenyl)butanoate</i>	Ex 2932 99 00	1369021-80-6
14	3-(1,3-benzodioxol-5-yl)-2-methyl-oxirane-2-carboxylic acid (PMK glycidic acid) (7)		2932 99 00	2167189-50-4
15	Isopropylidene (2-(3,4-methylene-dioxyphenyl)acetyl)malonate (IMDPAM) (8)	<i>IMDPAM</i>	2932 99 00	
16	N-phenyl-1-(2-phenylethyl)piperidin-4-amine	<i>4-anilino-N-phenethylpiperidine (ANPP)</i>	2933 36 00	21409-26-7
17	1-(2-phenylethyl)piperidin-4-one	<i>N-phenethyl-4-piperidone (NPP)</i>	2933 37 00	39742-60-4

Tabela IV - Prekursorët

18	N-phenylpiperidin-4-amine (4-AP)	2933 39 99	23056-29-3
19	Tert-butyl 4-anilinopiperidine-1-carboxylate (1-boc-4-AP)	2933 39 99	125541-22-2
20	N-phenyl-N-(piperidin-4-yl) propa-namide (norfentanyl)	2933 39 99	1609-66-1
21	Ephedrine	2939 41 00	299-42-3
22	Pseudoephedrine	2939 42 00	90-82-4
23	Norephedrine	2939 44 00	14838-15-4
24	Ergometrine	2939 61 00	60-79-7
25	Ergotamine	2939 62 00	113-15-5
26	Lysergic acid	2939 63 00	82-58-6
27	(1R,2S)-(-)-chloroephedrine	2939 79 90	110925-64-9
28	(1S,2R)-(+)-chloroephedrine	2939 79 90	1384199-95-4
29	(1S,2S)-(+)-chloropseudoephedrine	2939 79 90	73393-61-0
30	(1R,2R)-(-)-chloropseudoephedrine	2939 79 90	771434-80-1

Format stereoisomerike të substancave të listuara në këtë Kategori, që nuk janë katina (3), sa herë që ekzistenca e këtyre formave është e mundur.

Kripërat e substancave të listuara në këtë Kategori, sa herë që ekzistenca e tyre është e mundur dhe që nuk janë kripëra të katinës.

(1) Gazeta Zyrtare e Komunitetit Evropian L 290, 28.10.2002, p. 1.

(2) Numri CAS është 'numri i regjistrimit të shërbimit të përmbledhjeve kimike (Chemical Abstracts Service)', i cili është një identifikues numerik unik, specifik për çdo substancë dhe për strukturën e saj. Numri CAS është specifik për çdo izomer dhe për çdo kripë të çdo izomeri. Duhet të kuptohet që numrat CAS për kripërat e substancave të listuara më sipër do të jenë të ndryshëm nga ata të dhënë.

(3) I emëruar gjithashtu si (+)-norpseudoephedrine, CN code 2939 43 00, CAS No 492-39-7.

(4) I emëruar gjithashtu si ethyl 3-oxo-2-phenylbutanoate, bazuar në IUPAC (The International Union of Pure and Applied Chemistry - Bashkimi Ndërkombëtar për Kiminë e Pastër dhe të Zbatuar).

(5) I emëruar gjithashtu si methyl 2-(2H-1,3-benzodioxol-5-yl)-3-oxobutanoate, according to IUPAC.

(6) Dhe esterët e tij etilik, metilik (Nr. CAS 80532-66-7), propilik, izopropilik, butilik, izobutilik, sek-butilik dhe tert-butilik, me të njëjtin kod CN si acidi glicidik BMK.

(7) Dhe esterët e tij etilik (Nr. CAS 28578-16-7), metilik (Nr. CAS 13605-48-6), propilik, izopropilik, butilik, izobutilik, sek-butilik dhe tert-butilik, me të njëjtin kod CN si acidi glicidik PMK

(8) I njohur gjithashtu si 5-[2-(1,3-benzodioxol-5-il)acetil]-2,2-dimetil-1,3-dioksan-4,6-dion, sipas IUPAC (Bashkimi Ndërkombëtar për Kiminë e Pastër dhe të Zbatuar).

Tabela IV - Prekursorët

Kategoria 2				
Nr.	Prekursorët	Dizajnimi CN (nëse është ndryshe)	CN Kodi	CAS Nr.
1	Red phosphoru		2804 70 10	7723-14-0
2	Anthranilic acid	(2-aminobenzoic acid)	2922.43	118-92-3
3	Acetic anhydride	(acetic oxide)	2915.24	108-24-7
4	Phenylacetic acid	(benzeneacetic acid)	2916.34	103-82-2
5	Piperidine	(piperidine)	2933.32	110-89-4
6	Potassium permanganate	(permanganic acid (HMnO ₄), potassium salt)	2841.61	7722-64-7

Kripërat e substancave të listuara në këtë Kategori, sa herë që ekzistenca e tyre është e mundur.

Kategoria 3				
Nr.	Prekursorët	Dizajnimi CN (nëse është ndryshe)	CN Kodi	CAS Nr.
1	Hydrochloric acid	Hydrogen chloride	2806 10 00	7647-01-0
2	Sulphuric acid		2807 00 00	7664-93-9
3	Toluene		2902 30 00	108-88-3
4	Ethyl ether	Diethyl ether	2909 11 00	60-29-7
5	Acetone		2914 11 00	67-64-1
6	Methylethylketone	Butanone	2914 12 00	78-93-3

Kripërat e substancave të listuara në këtë Kategori, sa herë që ekzistenca e tyre është e mundur dhe që nuk janë kripëra të acidit klorhidrik dhe acidit sulfurik.

Kategoria 4				
Nr.	Prekursorët	Dizajnimi CN (nëse është ndryshe)	CN Kodi	CAS Nr.
1	Produkte mjekësore dhe produkte veterinarë mjekësore që përmbajnë efedrinë ose kripërat e saj	Përmban efedrinë ose kripërat e saj	3003 41 00	3004 41 00
2	Produkte mjekësore dhe produkte veterinarë mjekësore që përmbajnë pseudo-efedrinë ose kripërat e saj	Përmban pseudoefedrinë (INN) ose kripërat e saj	3003 42 00	3004 42 00

Plotësimi / ndryshimi i Tabelave si shtojcë e Ligjit Nr.02/L-128 për barna narkotike,
substancia psikotrope dhe prekursorë

VËREJTJE

Plotësimi dhe ndryshimi i tabelave

Bazuar në nenin 10 të Ligjit 02/L-128, tabelat mund të plotësohen edhe me bimë, narkotikë dhe prekursorë të tjerë, si dhe mund të çvendosen bimët dhe narkotikët nga një Tabel në tjetrën, nëse për këtë shfaqet nevoja.

Përgatesat:

Bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.02/L-128, përgatesat i nënshtrohen dispozitave të njëjta të këtij ligji sikurse edhe substancia të cilën e përmban. Nëse përgatesa përmban dy ose më tepër narkotikë, i nënshtrohet dispozitave të cilat aplikohen për substancën e cila paraqet rrezikshmëri më të lartë.

Përfshirja e përgatesave nga dispozitat ligjore të caktuara:

Bazuar në paragrafin 11.3 të nenit 11 të Ligjit Nr.02/L-128, përgatesat që përmbajnë substancia nga Tabela I, II, III dhe IV, përjashtohen nga masat kontrolluese që kanë të bëjnë me qarkulluesit farmaceutik me pakicë, që përfshinë paragrafin 12.7 deri 12.10 të nenit 12 të Ligjit Nr.02/L-128. Përfshirja është e bazuar në paragrafin 11.3 të nenit 11 të Ligjit Nr.02/L-128.

Referencë:

1. *Konventa e Vetme e Kombeve të Bashkuara për Narkotikë e vitit 1961;*
2. *Konventa e Kombeve të Bashkuara për Substancia Psikotrope e vitit 1971;*
3. *Rregulloret e Bashkimit Europian për prekursorë;*
4. *Lista e barnave të regjistruara në Agjencionin Europian për Mjekësi (EMA);*
5. *Lista e klasifikimit të barnave sipas ATC kodit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH);*
6. *Lista e barnave të regjistruara për qarkullim në Republikën e Kosovës, e publikuar në faqen zyrtare të Agjencionit të Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;*
7. *Listat e legjislacionit të vendeve të BE-së dhe më gjerë për substance të kontrolluara.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 100,000€ (njëqind mijë eurosh) për Organizimin dhe realizimin e Paketës së Partnerit të Vendit (Country Partner Package) në kuadër të kongresit dyditor "Future Industry Minds 2026", që do të mbahet më 11 dhe 12 maj 2026, në "Grand hotel Schloss Bensberg", në Gjermani.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami "Programi për Promovim të Vendit" dhe barten në Credit institution Commerzbank AG, Berlin, në xhirrollogarinë IBAN DE29 1004 0000 0449 4001 00.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, si dhe nenet 9 dhe 13 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2025 për Kushtet e Bartjes së Pronësisë së Pronës Publike dhe Dhënia me Qira e Sendeve në Pronësi Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet qiradhënia për hapësirën kioskë 14.4 m², e cila gjendet në kuadër të Terminalit Doganor Hani i Elezit dhe shtrihet në parcelën P-73317036-00300-9 Zona Kadastrale, Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit, sipas kërkesës nga Dogana e Kosovës/Ministria e Financave, në kohëzgjatje prej 36 muajsh, për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike në fushën e gastronomisë.
2. Obligohen Dogana e Kosovës/Ministria e Financave dhe ofertuesit e suksesshëm, që brenda 30 ditësh ta nënshkruajnë kontratën për dhënien me qira, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Dogana e Kosovës/Ministria e Financave, Komuna Hani i Elezit dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e pikës 1. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Zyra për Administrimin e Pronës Publike, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me datë 23.03.2026, në mënyrë zyrtare, përmes shkresës Protokoll Nr. 244 "Kërkesë për vendimarrje për lëshim me qira të pronës publike", ka pranuar nga Dogana e Kosovës/Ministria e Financave Kërkesën për marrjen e Vendimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike për lëshim me qira të dy hapësirave (kioskë dhe restorant me kuzhinë) në kuadër të Terminalit Doganor Hani i Elezit, të cilat shtrihen në parcelën P-73317036-00300-9, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit.

Për lëshimin me qira të këtyre hapësirave, Dogana e Kosovës ka përgatitur dosjen sipas legjislacionit në fuqi, e cila ka përmbajtur të dhënat e Autoritetit kontraktues, të dhënat bazë për pronën ku përfshihet lokacioni, sipërfaqja e propozuar për qira, destinimi aktual dhe ai i propozuar për qira, numrin e parcelës, dokumentet e pronësisë, duke përfshirë Vendimin Përfundimtar të Qeverisë për shpronësim Nr. 24/233, datë 27.11.2024, kohëzgjatjen e qirasë për 36 muaj, vlerësimin nga eksperti i licencuar për vlerën e tregut të hapësirave, si dhe vlerën e qirasë mujore për këtë kategori.

Me datë 29.09.2025, Zyra për Administrimin e Pronës Publike ka pranuar shkresën nr. Prot. 988 në ZKM, me subjekt kërkesë "Kërkesë për marrje të pëlqimit për lëshim me qira të objekteve në pronësi publike", dy hapësira të cilat janë në kuadër të Terminalit Doganor Hani i Elezit dhe shtrihen në parcelën nr. P-73317036-00300-9. Tutje, për shqyrtimin e Kërkesës është zbatuar neni 10, paragrafi 2, i Rregullores (QRK) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e ZAPP-së në Zyrën e Kryeministrit, mirëpo u vërtetua se asnjë institucion tjetër nuk ka interes publik për atë pronë.

Pas inspektimit në terren nga zyrtarët e ZAPP-së dhe konstatimit se këto hapësira shfrytëzohen për të njëjtin qëllim, siç edhe janë propozuar të jepen me qira, me datë 20.10.2025 prot. 988/20 ZAPP lëshon Pëlqimin Parimor, me udhëzimin juridik që duhet ndjekur nga Dogana e Kosovës, njërën nga dy procedurat e dhënies me qira pas pranimit Pëlqimit Parimor, atë të Ankandit Publik apo Grumbullimit të Ofertave, duke respektuar çmimin fillestar të vlerës së tregut të pranuar nga vlerësuesi i licencuar.

Tutje, janë zhvilluar procedurat sipas legjislacionit në fuqi nga Dogana e Kosovës, e cila ka ndjekur procedurat ligjore, dhe me datë 10.02.2026 është bërë njoftimi për grumbullimin e ofertave për dhënien me qira të hapësirës për kioskë në Terminalin Doganor Hani i Elezit, sipas çmimit fillestar mujor 65.00€ bruto për gjithsej 14.4 m² + 135.00€ shtesë për shpenzime të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave. Me datë 26.02.2026, Komisioni i emëruar me vendim nga ZKA nr. 05 datë 20.02.2026, nxjerr raportin dhe rekomandon që kontrata për dhënien me qira të kioskës në Terminalin Doganor Hani i Elezit, sip. prej 14.4 m², për 36 muaj me çmimin 476.00€ + 135.00€ shtesë për shpenzime të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave t'i jepet Halil Livoreka B.I. Me datë 26.02.2026 është nxjerrë Njoftimi për ofertuesin e suksesshëm për Halil Livoreka B.I. Hani i Elezit.


Po ashtu, është përpiluar draft-kontrata me titull "Dhënia me qira e kioskës në Terminalin Doganor Hani i Elezit", për sipërfaqen 14.4 m², në kohëzgjatje 36 muaj dhe çmimi mujor i qirasë është gjithsej 476.00€ + 135.00€ shtesë për shpenzime të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave.

Duke marrë parasysh arsyetimin, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesë administrative. Palët e pakënaqura mund të paraqesin padi për inicimin e konfliktit administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Doganës së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 18/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/-L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, KOSTT-it dhe KfW-së, për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë (Faza VII) - Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit.
2. Obligohet Ministria e Financave për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, si dhe nenet 9 dhe 13 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2025 për Kushtet e Bartjes së Pronësisë së Pronës Publike dhe Dhënia me Qira e Sendeve në Pronësi Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet qiradhënia për hapësirën restorant, me sipërfaqe 265 m², e cila gjendet në kuadër të Terminalit Doganor Hani i Elezit dhe shtrihet në parcelën P-73317036-00300-9, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit, sipas Kërkesës nga Dogana e Kosovës/Ministria e Financave, në kohëzgjatje prej 36 muajsh për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike në fushën e gastronomisë.
2. Obligohen Dogana e Kosovës/Ministria e Financave dhe ofertuesi i suksesshëm, që brenda 30 ditësh ta nënshkruajnë kontratën për dhënien me qira, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Dogana e Kosovës/Ministria e Financave, Komuna Hani i Elezit dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e pikës 1. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Zyra për Administrimin e Pronës Publike, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me datë 23.03.2026, në mënyrë zyrtare përmes shkresës Protokoll Nr. 244 "Kërkesë për vendimmarrje për lëshim me qira të pronës publike", ka pranuar nga Dogana e Kosovës/Ministria e Financave Kërkesën për marrjen e vendimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike për lëshim me qira të dy hapësirave (kioskë dhe restorant me kuzhinë) në kuadër të Terminalit Doganor Hani i Elezit, të cilat shtrihen në parcelën P-73317036-00300-9, Zona Kadastrale, Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit.

Për lëshimin me qira të këtyre hapësirave Dogana e Kosovës ka përgatitur dosjen sipas legjislacionit në fuqi, e cila ka përmbajtur të dhënat e Autoritetit kontraktues, të dhënat bazë për pronën ku përfshihet lokacioni, sipërfaqja e propozuar për qira, destinimi aktual dhe ai i propozuar për qira, numrin e parcelës, dokumentet e pronësisë, duke përfshirë Vendimin Përfundimtar të Qeverisë për shpronësim Nr. 24/233, datë 27.11.2024, kohëzgjatjen e qirasë për 36 muaj, vlerësimin nga eksperti i licencuar për vlerën e tregut të hapësirave, si dhe vlerën e qirasë mujore për këtë kategori.

Me datë 29.09.2025, Zyra për Administrimin e Pronës Publike, ka pranuar shkresën nr. Prot. 988 në ZKM me subjekt kërkesë "Kërkesë për marrje të pëlqimit për lëshim me qira të objekteve në pronësi publike", dy hapësira të cilat janë në kuadër të Terminalit Doganor Hani i Elezit dhe shtrihen në parcelën nr. P-73317036-00300-9. Tutje, për shqyrtimin e Kërkesës është zbatuar neni 10, paragrafi 2, i Rregullores (QRK) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e ZAPP-së në Zyrën e Kryeministrit, mirëpo u vërtetua se asnjë institucion tjetër nuk ka interes publik për atë pronë.

Pas inspektimit në terren nga zyrtarët e ZAPP-së dhe konstatimit se kjo hapësirë shfrytëzohet për të njëjtin qëllim siç edhe është propozuar të jepet me qira, me datë 20.10.2025 prot. 988/20 ZAPP lëshon Pëlqimin Parimor, me udhëzimin juridik që duhet ndjekur nga Dogana e Kosovës njëhën nga dy procedurat e dhënies me qira pas pranimit Pëlqimit Parimor, atë të Ankandit Publik apo Grumbullimit të Ofertave, duke respektuar çmimin fillestar të vlerës së tregut të pranuar nga vlerësuesi i licencuar.

Tutje, janë zhvilluar procedurat sipas legjislacionit në fuqi nga Dogana e Kosovës, me datë 10.02.2026 është bërë njoftimi për grumbullimin e ofertave për dhënien me qira të hapësirës së bufesë në Terminalin Doganor, Hani i Elezit, sipas çmimit fillestar mujor 800.00€/muaj bruto për gjithsej 265 m² + 300.00€ shtesë për shpenzime të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave. Ndërsa, me datë 23.02.2026 është bërë anulimi i njoftimit për arsye të mosplotësimit të të gjitha kushteve të publikimit.

Tutje, me datë 25.02.2026 është bërë publikimi i ri për njoftimin për grumbullimin e ofertave për dhënien me qira të hapësirës bufesë në Terminalin Doganor, Hani i Elezit, sipas çmimit fillestar mujor 800.00€/muaj bruto, për 265 m² + 300.00€ shtesë për shpenzime të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave. E njëjta është publikuar edhe në portalin "Telegrafi".

Me datë 12.03.2026, Komisioni i emëruar me vendim nga ZKA, nr. 05 datë 09.03.2026 nxjerr raportin dhe rekomandon që kontrata për dhënien me qira të bufesë/restorantit në Terminalin Doganor, Hani i Elezit, prej 265 m² për 36 muaj, me çmimin 1,550.00€ + 300.00€ shtesë për shpenzime të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave t'i jepet Arbër Kuka B.I.

Me datë 13.03.2026 është nxjerrë Njoftimi për ofertuesin e suksesshëm për Arbër Kuka B.I., Hani i Elezit.

Në bazë të kësaj është përpiluar draft-kontrata me titull "Dhënia me qira e bufesë/restorantit në Terminalin Doganor Hani i Elezit", për sipërfaqen 265 m² me kohëzgjatje 36 muaj dhe çmimi mujor i qirasë është gjithsej 1,550.00€ + 300.00€ shtesë për shpenzime të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave.

Duke marrë parasysh arsyetimin, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesë administrative. Palët e pakënaqura mund të paraqesin padi për inicimin e konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Doganës së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Kontrollit të Tregtisë me Mallra Strategjike.
2. Obligohen Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030".
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/11
Datë: 20.04.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ekzekutiv për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian (në tekstin e mëtejme: Komisioni Ekzekutiv), në këtë përbërje:
 - 1.1. Kryeministri i Republikës së Kosovës - Kryesues;
 - 1.2. Zëvendëskryeministri i Parë dhe Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës - zëvendëskryesues;
 - 1.3. Kryenegociatori i Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian - zëvendëskryesues;
 - 1.4. Ambasadori/ja i/e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës - anëtar/e.
2. Me qëllim të koordinimit institucional Presidenca dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ftohen të emërojnë përfaqësuesin e tyre në Komisionin Ekzekutiv.
3. Komisioni Ekzekutiv ka për synim mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Ekzekutiv të themeluar sipas pikës 1 të këtij Vendimi, përfshijnë por nuk kufizohen në intensifikimin e punës për ndërmarrjen dhe koordinimin e veprimeve konkrete për procesin e anëtarësimit dhe të gjitha detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit, duke mundësuar:
 - 4.1. Marrjen e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE;
 - 4.2. Hapjen e negociatave të anëtarësimit;
 - 4.3. Sigurimin e mbështetjes për anëtarësim nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së.
5. Komisioni Ekzekutiv mbështetet nga një sekretariat teknik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, i koordinuar nga Kryenegociatori.
6. Kryenegociatori ngarkohet me koordinimin e punës ndërinsticionale dhe autorizohet të themelojë Task Forca, sipas fazave dhe nevojave të procesit të anëtarësimit.
7. Në bazë të autorizimit të pikës 6. të këtij Vendimi, Kryenegociatori themelon Task Forcën për Statusin e Vendi Kandidat (në tekstin e mëtejme: Task Forca), si strukturën e parë operative ndërinsticionale me mandat specifik për marrjen e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

8. Komisioni Ekzekutiv njoftohet për themelimin e task forcave nga Kryenegociatori.
9. Komisioni Ekzekutiv sipas nevojës, mund të ftojë në takim ose të zgjerojë bashkëpunimin me përfaqësues të institucioneve tjera apo bashkëpunëtorë të jashtëm.
10. Obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi në pajtim me legjislacionin në fuqi.
11. Përmes këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 18/94, i datës 24 gusht 2022.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Kryenegociatorit me BE-në
- Shefit të Stafit të Kryeministrit
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 128 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, neneve 3 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të ruajtjes së sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale, mbrojtjes së interesave shtetërore dhe pjesëmarrjes aktive në aleancat ndërkombëtare për luftimin e grupeve terroriste, dhe në përputhje me bashkëpunimin e ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe partnerët e tjerë, vendos të shpallë Organizatën e Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) si organizatë terroriste në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Ky Vendim bazohet në:
 - 12.1. Vendimin e Këshillit (CFSP) 2026/421 të Bashkimit Evropian, i miratuar më 19 shkurt 2026;
 - 12.2. Shpalljen e IRGC-së si organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në përputhje me 8 U.S.C. § 1189, publikuar në Regjistrin Federal, faqe 73, Fed. Reg. 44 795, më 15 prill 2019 (FR Doc. 2019-07415);
 - 12.3. Rezolutën 1747 (2007), si dhe Rezolutën 1929 (2010), të miratuara nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.
3. Organet përgjegjëse të sigurisë të Republikës së Kosovës obligohen, që në pajtim me praktikatat ndërkombëtare, t'i ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/11
Datë: 20.04.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, sipas përbërjes së re:
 - 1.1. Arian Gashi, Kryetar i Komisionit dhe zëvendësanëtar i Komisionit Ersan Qavolli, pyetës për lëndën: E Drejta Penale (materiale dhe procedurale);
 - 1.2. Lumni Sallauka, zëvendëskryetar i Komisionit dhe zëvendësanëtar Arsim Hamzaj, pyetës për lëndën: E Drejta Civile (materiale dhe procedurale);
 - 1.3. Anita Prenaj - Krasniqi, anëtare dhe zëvendësanëtare Suada Rama - Hamza, pyetës për lëndën: E Drejta Kushtetuese dhe Bazat e Sistemit Gjyqësor;
 - 1.4. Burim Shala, anëtare dhe zëvendësanëtar Nehat Qelaj, pyetës për lëndën: E Drejta Tregtare, E Drejta e Punës dhe e Drejta Administrative; dhe
 - 1.5. Bujar Muzaqi, anëtar dhe zëvendësanëtare Rrezarta Lleshaj, pyetës për lëndën: E Drejta Ndërkombëtare (private dhe publike) dhe E Drejta e Bashkimit Evropian.
2. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.20/165, i datës 12 tetor 2023, si dhe Vendimi Nr. 01/168, i datës 23 tetor 2023.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, të aprovuar me këtë Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e Komisionit sipas pikës 1. të këtij Vendimi, t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim, me miratimin e të cilit zëvendësohet përbërja aktuale e Komisionit e miratuar më parë nga Kuvendi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë